

FOL

TETOR
2017

DIALOGU SOCIAL: ROLI, DHE MANDATI I KËSHILLIT EKONOMIK SOCIAL

LËVIZJA FOL

Të drejtat e autorit © 2017.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të Lëvizjes FOL.

Përkrahur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

EYE Enhancing Youth
Employment

Ky punim është përgatitur në kuadër të kornizës të platformës “FOL Hapur” që mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, dhe implementohet nga “Helvetas Swiss Cooperation” dhe MDA. Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si diçka që reflekton pozicionin e Zyres Zvicerane për Bashkëpunim ose të Departamentit Zviceran për marrëdhënie të jashtme.

Hyrje

Ky dokument politikash është i ndarë në disa pjesë ku janë analizuar: legjislacioni dhe rrjedhimisht mandati i Këshillit Ekonomiko-Social në Kosovë (KES), puna dhe të arriturat e KES-it që nga themelimi, krahasimin e KES-it me vende tjera, dhe rekomandimet për të rritur impaktin e KES-it.

Dialogu social është pjesë kyçe e këtij punimi. Dialogu social është një proces shumë i rëndësishëm për funksionimin e duhur të shtetit dhe për një sistem demokratik të qeverisjes. Në Kosovë, si term, por edhe në politikbërje, dialogu social nuk është shumë i njohur për publikun e gjerë. Organizata Ndërkombëtare e Punës e cilëson dialogun social si rrënjësor në demokraci, dhe në veçanti e konsideron si shumë të rëndësishme pjesëmarrjen e Shtetit në këtë proces¹. Dialogu social funksionon në parimin që përfaqësuesit/et nga Qeveria, punëdhënësit/et, dhe punëtorët/et, shkëmbejnë informacione të cilat rrjedhimisht do të ndihmonin në përpilimin e politikave sociale dhe ekonomike sa më të mira.

Këshilli Ekonomik Social në Kosovë mbartë në vete rolin e shtyrjes përpara të dialogut social. Si mekanizëm që bën bashkë përfaqësuesit e punëdhënësve/eve, punëmarrësve/eve, dhe Qeverisë, padyshim se KES ka për detyrë që të sigurojë gjithpërfshirje në dialog, duke ngritur vetëdijen mbi dialogun social dhe nxitjen e të gjithë shoqërisë të jetë pjesë në të, përfshirë këtu edhe rininë.

Edhe pse puna e KES shtrihet përgjatë një spektri të gjerë të politikave sociale e ekonomike, iniciativat e KES të cilat kanë marrë më së shumti bujë dhe kanë pasur ndikim direkt në jetën e qytetarëve janë: (a) Negocimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive; dhe (b) Propozimi i Pagës Minimale. Propozimet mbi iniciativa të tilla, KES i drejton në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe me raste në Kuvend. Dialogu social i suksesshëm ndikon që të përpilohen politika ekonomike dhe sociale që rrisin mirëqenien e qytetarëve/eve, mirëpo, në Kosovë nuk mund të thuhet se ky i fundit ka pasur ndonjë impakt madhor. Ky punim shtjellon mangësitë që gjenden në zhvillimin e një dialogu social të suksesshëm. Më konkretisht punimi ka për synim të analizojë institucionin e KES-it, dhe të jep rekomandime se si ky institucion, bazuar edhe në praktika në vende tjera, mund të ketë rol më rrënjësor në politikbërje në vend.

¹ International Labour Organization. Marrë nga: <http://www.ilo.org/ifpdial/areas-of-work/social-dialogue/lang--en/index.htm>%20%20a

Dialogu social dhe format e dialogimit

Organizata Ndërkombëtare e Punës e definon dialogun social si proces që përfshinë negocimin, konsultimin apo thjesht shkëmbimin e informatave në mes të përfaqësuesve të Qeverisë, punëdhënësve dhe të punëtorëve, në çështjet me interes të përbashkët që kanë të bëjnë me ekonominë dhe politikat sociale.

Negocimi është forma më e shpeshtë e dialogut social. Palët mund të involvohen në negociata në ndërmarrje, në negociata regjionale apo edhe nacionale, ndërsa konsultimi nënkupton angazhimin e palëve për të shkëmbyer pikëpamjet e tyre në një dialog më të detajuar. Në fund të konsultimit palët mund të dalin me marrëveshje formale. Zakonisht këto marrëveshje kanë karakter rekomandues dhe informativ, kurse shkëmbimi i informacioneve është njëri nga elementet më të rëndësishme për dialog social efektiv. Nuk përbën diskutim real, por vetëm shkëmbim i informatave mes organizatave dhe palëve në procesin e dialogut².

Dialogu social zakonisht nuk është i njëjtë në të gjitha vendet. Nuk ekziston një model i dialogut social i cili mund të kopjohet nga një shtet në shtetin tjetër. Andaj, në mënyrë që dialogu social të jetë i suksesshëm duhet që të adaptohet në kornizat ligjore, traditat dhe praktikatat nacionale. Dialogu social në botë zhvillohet në disa forma të ndryshme. Ai mund të jetë si proces trepalësh, me qeverinë si palë zyrtare e dialogut, apo si marrëdhënie dypalëshe vetëm në mes të përfaqësuesve të punëtorëve dhe punëdhënësve me ose pa përfshirjen indirekte të qeverisë. Kështu, dialogu mund të zhvillohet në nivel nacional, rajonal, apo lokal.

Legjislacioni në fuqi në Kosovë

Deri në vitin 2011, dialogu social në Kosovë zhvillohej në baza ad-hoc, pa ndonjë mënyrë të strukturuar të dialogimit. Fillimisht në vitin 2001 është nënshkruar marrëveshja mbi themelimin e Këshillit Konsultativ Trepalësh. Kështu që me qëllim të inicimit të konsultimeve ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve, të institucioneve qeveritare në Kosovë, dhe forcimit të dialogut në mes të partnerëve social është nxjerrë Udhëzimi Administrativ nr. 2001/17, Mbi strukturën dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ Trepalësh³.

Pas riemërimit të Këshillit Konsultativ Trepalësh në Këshillin Ekonomiko-Social në vitin 2009, Qeveria e Kosovës nxjerr vendimin nr. 09/57 të datës 13.03.2009 me të cilin rregullohej organizimi i punës, fushë veprimtaria dhe funksioni i KES-it. Në vitin 2011 përfundimisht miratohet Ligji Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social me ç ‘rast shfuqizohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 2001/17 dhe Vendimi 09/57 i Qeverisë së Kosovës. Që nga ai vit organizimi, fushë veprimtaria, format e punës dhe funksioni i KES-it rregullohen me Ligjin për KES si dhe me Rregulloren e Punës së KES të vitit 2012.

Sipas **Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social**, KES është organ i nivelit nacional, i cili udhëheq konsultimet dhe bënë propozime organeve kompetente për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me politikat ekonomike në Republikën e Kosovës⁴. Gjithashtu ligji përcakton përbërjen e KES-it, kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES për organizatat e punëdhënësve dhe të punësuarve. Ndërsa funksionet e KES-it janë: këshillimi dhe udhëzimi i institucioneve të Kosovës, nxitja e konsultimeve mes palëve, nënshkrimi i marrëveshjeve kolektive, propozimin e pagës minimale etj.

² International Labour Organization. “Social dialogue, finding a common choice” Marrë nga: <http://www.ilo.org/public/english/dialogue/download/brochure.pdf>

³ Web Faqja e KES. Historiku. Marrë nga: <http://kes-rks.org/Al/rreth-nesh/4/brief-history/>

⁴ Gazeta Zyrtare Kosovë. Ligji nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social. Neni 5. 10 Gusht, 2011. Marrur nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2747>

Rregullorja e Punës e Këshillit Ekonomiko-Social rregullon kompetencat, të drejtat funksionet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KES-it, si dhe jep sqarime mbi vendimmarrjen në KES⁵. Duhet të përmendim që, edhe pse dokument publik, Rregullorja e Punës së KES, në momentin kur po përpilohet ky raport, nuk është e qasshme. Ajo nuk gjendet as në ëeb-faqen e Këshillit, e as në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ne i kemi dërguar e-mail Këshillit ku kemi kërkuar që të konsultojmë rregulloren, si dhe kemi kërkuar sqarime se pse rregullorja nuk është e publikuar, mirëpo nuk kemi marrë përgjigje nga KES.

Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social edhe pse ka 6 vite që është miratuar në Kuvendin e Kosovës ende nuk është duke u zbatuar në tërësi. Mungesa e ministrave në takime, mosraportimi për takimet publike, mos publikimi i raporteve të punës si dhe problemet me menaxhimin e buxhetit të Këshillit përbëjnë një pjesë të problemeve të implementimit të ligjit. Si i tillë ligji ka mangësi në zbatim dhe vetëm në vitin 2016 ka pasur hapa konkret për ndryshimin e këtij ligji.

Në takimin e Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve Evropian, në lidhje me politikat sociale të punësimit dhe arsimit, sa i përket mirëqenies sociale, Komisioni Evropian ka theksuar nevojën që Kosova të zbatojë Ligjin për Këshillin Ekonomik dhe Social, si një hap të rëndësishëm në sigurimin e një dialogu social përmbajtësor dhe cilësor⁶.

Se Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social duhet të ndryshohet e thotë edhe Raporti i Progresit për Kosovën i Bashkimit Evropian i vitit 2016. Sipas këtij raporti ligji duhet të ndryshohet me qëllim që të forcohet kapaciteti i Këshillit dhe për të përmirësuar cilësinë e dialogut social. Në takimin e Këshillit Ekonomiko-Social me datë 12 dhjetor 2016, është propozuar drafti i parë për plotësim-ndryshimin e ligjit për KES⁷. Ndërsa në programin legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2017, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është përfshirë projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 008 për Këshillin Ekonomik dhe Social⁸. Mbetet të shihet se a do të ketë ndryshime thelbësore në këtë projektligj, çka do të ndikonte në punën më të mirë të Këshillit, si dhe zbatimin më të drejtë të dispozitave të Ligjit.

Krahasim i legjislacionit të Kosovës dhe vendeve të rajonit në fushën e dialogut social

Shumica e vendeve të rajonit e kanë të rregulluar fushën e dialogut social me akte ligjore. Sipas një komunikate të Aleancës Kosovare të Bizneseve, modeli i Këshilli Ekonomiko-Social i Kosovës është vlerësuar si më i miri ndër 6 vendet e Ballkanit Perëndimor⁹.

Në vazhdim do të bëjmë një krahasim të modeleve të Këshillave Ekonomiko-Social të disa shteteve¹⁰.

⁵Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Hulumtim Parlamentar mbi Këshillin Ekonomiko-Social. Qershor 2015. Marrë nga: <http://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2016/11/HP-Këshillin-Ekonomik-Social.pdf>

⁶ Republika e Kosovës. Ministria e Integritimit Evropian. Marrë nga: <http://www.mei-ks.net/sq/lajmet/qeveria-e-kosoves-dhe-ke-diskutaun-sot-ne-prishtine-politikat-sociale-dhe-te-punesimit-te-arsimit-kerkimit-shoqerise-informative-dhe-medias>

⁷ Web faqja e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Marrë nga: <http://mpms.rks-gov.net/Lajmet/Publikimiilajmeve/tabid/116/articleType/ArticleView/articleId/3921/language/sq-AL/Mbahet-takimi-i-rregullt-i-Keshillit-EkonomikoSocial.aspx>

⁸ Programi Legjislativ i Qeverisë 2017. Marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_LEGJISLATIV_PER_2017_.pdf

⁹ Ekonomia Online. "Këshilli ekonomik-social i Kosovës model në rajon". <http://www.ekonomiaonline.com/ekonomi/biznes/keshilli-ekonomiko-social-kosoves-model-ne-regjion/>

¹⁰ Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Hulumtim Parlamentar mbi Këshillin Ekonomiko-Social. Qershor 2015. Marrë nga: <http://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2016/11/HP-Këshillin-Ekonomik-Social.pdf>

	Kosovë	Mali i Zi	Slloveni	Serbi
Përbërja	5 përfaqësues të Organizatave të punëdhënësve	11 përfaqësues të Organizatave të punëdhënësve	8 përfaqësues të Organizatave të punëdhënësve	6 përfaqësues të Organizatave të punëdhënësve
	5 përfaqësues të Organizatave të punëtorëve	11 përfaqësues të Organizatave të punëtorëve	8 përfaqësues të Organizatave të punëtorëve	6 përfaqësues të Organizatave të punëtorëve
	5 përfaqësues të Qeverisë	11 përfaqësues të Qeverisë	8 përfaqësues të Qeverisë	6 përfaqësues të Qeverisë
Burimet e financimit	-Buxheti i Shtetit - Kontributet vullnetare të Organizatave të punëdhënësve dhe të punësuarve - donacionet vendore dhe ndërkombëtare	- Buxheti i shtetit	- Buxheti i shtetit	- Buxheti i shtetit -donacionet vendore dhe ndërkombëtare
Vendimmarrja	2/3 e anëtarëve të Këshillit		Me konsensus	Me Konsensus
Takimet	Këshilli mban takime të rregullta së paku një herë në muaj	Këshilli punon në sesione të rregullta, varësisht si caktohet nga anëtarët e tij	Së paku një herë në muaj, apo edhe më shpesh me kërkesë të anëtarëve	Së paku njëherë në muaj
Raportimi	Ligji nuk parasheh që Këshilli të raportojë për aktivitetet e tij, e as aktivitetet financiare	Këshilli i dërgon Qeverisë një raport financiar një herë në vit. Ky raport u dërgohet edhe partnerëve social	Ligji nuk e parasheh që Këshilli të raportojë për aktivitetet e tij, e as aktivitetet financiare	Sekretariati e përgatitë një raport të aktiviteteve si dhe raportin financiar. Ky raport u dërgohet palëve të interesit

 Tabela 1: Krahasimi i KES në vendet e ndryshme¹¹

Këshilli Ekonomiko-Social në Kosovë

Si u cek edhe më lartë, dialogu social, fillimisht në Kosovë, ka funksionuar përmes një Këshillit Konsultativ Trepalësh. Në vitin 2009, themelohet Këshilli Ekonomiko-Social i Kosovës, dhe merr timonin për shtyrjen përpara të dialogut social. Mirëpo, ligji që i mundësoi KES-it të ketë kompetencat e nevojshme për të zhvilluar dialogun social, por edhe për të shtyrë përpara politikat që shërbejnë në

¹¹ Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Hulumtim Parlamentar mbi Këshillin Ekonomiko-Social. Qershor 2015. Marrë nga: <http://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2016/11/HP-Këshillin-Ekonomik-Social.pdf>

rritje të mirëqenies, erdhi në vitin 2011. Ky ligj përcakton funksionet kryesore të Këshillit. Ndër funksionet kryesore që i posedon ky Këshill¹² janë:

- 1) krijimi, zhvillimi dhe përparimi i dialogut social;
- 2) nismat ligjore për nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga fusha e punës dhe punësimit, mbrojtjes sociale dhe politikave ekonomike në përgjithësi;
- 3) nxitjen e ideve për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve sociale në Kosovë;
- 4) politikat e nxitjes së punësimit, zbutjen e papunësisë, konkurrencën, produktivitetin e punës, çmimet, pagat
- 5) propozimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, si dhe për përpilimin, diskutimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së përgjithshme kolektive.

Fillimisht dokumenti do të trajtojë përbërjen e Këshillit, buxhetin e tij, mbajtjen e takimeve, dhe mënyrën e vendimmarrjes. Më pas do të kalojë nëpër pikat e mësipërme për të vlerësuar se çfarë ka arritur Këshilli gjatë viteve të funksionimit të tij.

Përbërja e Këshillit

Siç u pa në krahasimin e legjislacionit të disa shteteve, në të gjitha këto shtete këshilli ka përbërje trepalëshe. Nga të gjitha këto shtete, Këshilli Ekonomiko-Social i Kosovës ka numrin më të ulët të anëtarëve me gjithsej 15 anëtar. Numër më i madh i anëtarëve do të rezultonte në dialog më efektiv, si dhe përfaqësim më të denjë të punëtorëve dhe punëdhënësve, sepse do tu jepej mundësia që pjesë e Këshillit të jenë më shumë organizata përfaqësuese të punëtorëve dhe punëdhënësve.

Gjithashtu problematike është numri i vogël i organizatave përfaqësuese në Këshill. Momentalisht anëtarë në Këshill është vetëm një organizatë përfaqësuese e punëtorëve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), dhe dy organizata përfaqësuese të punëdhënësve (Aleanca Kosovare e Biznesit dhe Oda Ekonomike e Kosovës). Nga ana e Qeverisë janë Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministri i Shëndetësisë¹³.

Numri kaq i vogël i organizatave përfaqësuese në Këshill, është si rezultat i kriterëve specifike për përfaqësim në Këshill që i përcakton Këshilli. Këto kriterë janë më të thjeshta në vendet të cilat janë pjesë e krahasimit. Si shembull, në Slloveni përfaqësuesit e punëtorëve në Këshill janë nga 7 organizata, ndërsa përfaqësuesit e punëdhënësve vijnë nga 5 organizata të ndryshme. Prandaj me ndryshimin e Ligjit për KES do duhet të që të ndryshohen këto kriterë në mënyrë që të sigurohet përfaqësim sa më i gjerë i organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve në Këshill¹⁴.

Buxheti i Këshillit

Sipas ligjit, financimi i Këshillit bëhet nga tre burime:

- Nga buxheti i Shtetit
- kontributet vullnetare të Organizatave të punëdhënësve dhe të punësuarve
- donacionet vendore dhe ndërkombëtare

¹² Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko Social. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2747>. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2747>

¹³ Këshilli Ekonomiko-Social. Korrik, 2015. Marrë nga: http://kes-rks.org/uploads/files/2015/July/27/Broshuri_informuese_per_Kishillin_Ekonomik_Social_-_per_webfaqe1437992588.pdf

Sipas raportit të punës së Këshillit, të vitit 2014, ka pasur mangësi në implementimin e buxhetit. Si çështje tejet e ndjeshme që ndikon në punën edhe më të mirë të anëtarëve po edhe te sekretariatit dhe komisioneve profesionale të KES-it, është mos transparenca rreth buxhetit të KES-it. Mos transparenca për buxhetin e KES-it me të cilin menaxhon MPMS-ja, ku KES-i nuk ka kurrfarë qasje por nuk posedon as informata se si menaxhohet, edhe përkundur kërkesave të shumta me gojë dhe shkrim nga ana e Kryesuesit të KES-it.

Përfaqësuesit e KES kanë deklaruar se si pasojë e kësaj situatë janë krijuar obligime të pa nevojshme ndaj Kryesuesëve të KES-it, anëtarëve të sekretariatit dhe anëtarëve të komisioneve profesionale të KES-it që kanë punuar edhe pse kanë vendime për zgjedhjen e tyre, ku saktësohet edhe lartësia e kompensimit. Tani është krijuar një situatë e pa këndshme, ka kërkesa se këto obligime do t'i kërkojnë përmes rrugëve ligjore¹⁵.

Arsyet e jo transparencës së buxhetit është fakti se ligji nuk obligon as KES-in e as MPMS-në që të përgatitë raportin financiar, me ç'rast do të mund të monitorohej se ku po shpenzohet buxheti i KES-it.

Marrja e vendimeve

Këshilli vendimet i merr me 2/3 e votave të anëtarëve të përhershëm. Kjo mënyrë e vendimmarrjes nënkupton se në votimet e Këshillit, 2/3 e votave mund të arrihen edhe pa pëlqimin e njërit partner social. Në këtë rast, nëse dy partnerët social do të pajtoheshin për një vendim, do ta votonin atë edhe pa përkrahjen e partnerit tjetër social¹⁶. Prandaj si alternativë më e mirë do ishte që vendimmarrja të bëhet me konsensus, sikurse në vendet e rajonit. Votimi me konsensus, do të ishte më i vështirë për tu arritur, mirëpo do të siguronte se do të këtë më shume konsultime, dhe në fund vendimet e votuara me konsensus do ishin të pranueshme për të gjithë partnerët social.

Mbledhjet e Këshillit dhe Raportimi

Këshilli do duhet që të organizoj takime të rregullta së paku njëherë në muaj¹⁷.

Këshilli publikon shumë pak informacione për takimet publike, si dhe është raportuar se disa nga anëtarët e KES-it mungojnë në takime¹⁸. Kjo mund të jetë edhe si pasojë e asaj që KES nuk ka një kalendar paraprak se kur mbahen takimet, dhe në këtë mënyrë disa nga anëtarët për shkak se nuk kanë qenë të njoftuar më herët mund të mos marrin pjesë. Si alternativë mund të jetë që KES të publikojë në fillim të vitit kalendarin e takimeve në mënyrë që të gjithë anëtarët të jenë paraprakisht të njoftuar për takimet e Këshillit.

Një çështje tjetër me rëndësi është pjesëmarrja e OJQ-ve në takimet e KES. Sipas nenit 17.2 të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, në takimet e Këshillit mund të ftohen edhe OJQ të ndryshme për diskutimin e ndonjë çështjeje të rëndësishme. Mirëpo, nuk është raportuar për ndonjë takim kur kanë marrë pjesë OJQ. Këshilli do duhet të ftohet në takime OJQ me qëllim që ato të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve sociale.

Gjithashtu raportet për punën e këshillit janë të pakta. Në web-faqen e KES-it, e cila do të duhet të shërbente si pikë e parë e informimit të publikut me punën e KES-it, kjo nuk është aktive dhe nuk përmban informata. Mungesa e informatave e ul transparençën e këtij Këshilli, dhe rrjedhimisht edhe besimin në të.

¹⁵ Këshilli Ekonomik Social. Raporti i punës së Këshillit Ekonomiko- Social të Kosovës për periudhën maj 2013- Maj 2014. Marrë nga: <http://www.bspk.org/PDF/KES2014.pdf>

¹⁶ Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Hulumtim Parlamentar mbi Këshillin Ekonomiko-Social. Qershor 2015. Marrë nga: <http://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2016/11/HP-Këshillin-Ekonomik-Social.pdf>

¹⁷ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko Social. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2747>

¹⁸ Këshilli Ekonomik Social. Raporti i punës së Këshillit Ekonomiko- Social të Kosovës për periudhën maj 2013- Maj 2014. Marrë nga: <http://www.bspk.org/PDF/KES2014.pdf>

Sfidat dhe të arriturat e KES

Me qëllim që më mirë të kuptohet nëse KES ka arritur t'i përmbushë detyrimet e tij të përcaktuara me ligj, në vijim janë analizuar në 4 pika këto detyrime.

Pika 1: Krijimi, zhvillimi, dhe përparimi i dialogut social

Nga ajo që u tha më lartë, mund të përfundojmë se në kuadër të kornizës ligjore dhe rregullative, dialogu social në vend ka kaluar nëpër disa faza të rëndësishme dhe ka shënuar një përmirësim. Pra qysh nga fillimi i dialogut social në kuadër të Këshillit Trepalësh, deri tek hartimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit për KES, mënyra e dialogimit është strukturuar deri në një masë. Megjithatë, ajo që vazhdon të ngecë është pjesa e zhvillimit të mirëfilltë të tij dhe avancimit.

Në këtë aspekt, sfida hasen që nga përfaqësimi i partnerëve social në KES, ku kriteret për përfaqësim janë mjaft të ngushta dhe nuk lënë hapësirë për pjesëmarrje të shumë akterëve në mënyrë që dialogu të jetë më gjithëpërfshirës. Përderisa jemi tek gjithëpërfshirja, duhet theksuar se momentalisht mungon edhe përfaqësimi i duhur gjinor në KES, sidomos nga ana e punëmarrësve, ku nga 5 anëtarët të gjithë janë burra¹⁹. Ngjashëm, mungon edhe përfshirja e rinisë, nëse jo si anëtarë atëherë të paktën si vëzhgues dhe pjesëmarrës të takimeve.

Më tutje, në mënyrë që KES të ketë impaktin e duhur në politikëbërje, është e rëndësishme që ministrat të marrin pjesë nëpër takime të tij. Mirëpo, si është identifikuar edhe më lartë, ministrat jo shumë herë marrin pjesë në takimet e KES, dhe në këtë mënyrë çështjet e ngritura në takime nuk mund të përcillen nga ta në Qeveri.

Rol të rëndësishëm tek zhvillimi dhe avansimi i dialogut social luan edhe njoftimi i palëve të jashtme mbi punën e KES. Fatkeqësisht, palët e jashtme janë rrallëherë të njoftuara mbi diskutimet apo takimet e KES. Informimi i vetëm bëhet pas takimeve me anë të komunikatave për shtyp të përgatitura nga sekretaria. Kjo e fundit, gjithashtu nuk luan shumë rrol mbështetës në aspekt të hulumtimeve mirëpo më shumë shërben si mbështetje teknike/administrative.

Pra, krejt në fund, përkundër ekzistimit të kornizës ligjore deri diku të mirë, ajo që mbetet të bëhet është përmirësim i implementimit të saj.

Pika 2: Ndryshimet legislative dhe iniciativat për politika për përmirësimin e fushave të punës dhe punësimit

Në kuadër të fushë veprimtarisë së KES-it, është edhe zhvillimi i politikave për rritjen e punësimit dhe në të njëjtën kohë zvogëlimin e papunësisë. Edhe pse KES nuk mundet që si organ i vetëm të ndikojë në uljen e papunësisë në vend, veçanërisht duke pasur parasysh se ai nuk është organ vendimmarrës, nuk mund të themi se ky i fundit ka dhënë rekomandime konkrete ose ka shtyrë përpara për këtë pikë.

Nëse analizohet niveli i punësimit dhe papunësisë në bazë të të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (papunësia vazhdon të jetë në nivele tejet të larta, sidomos tek rinia), shihet se gjendja në këtë aspekt në vendin tonë nuk është aspak e favorshme. Ndër mekanizmat që duhet angazhuar në këtë aspekt është edhe KES-i, për të arriturat e të cilit e kemi të pamundur të flasim. Kjo, vjen si rezultat i asaj se informimi mbi punën e KES mungon. Andaj, edhe nëse deri më tani KES ka pasur iniciativa – qofshin ato legislative ose të politikave – ne si publik (apo palë e jashtme) nuk jemi të informuar mbi këtë.

Në këtë drejtim, është e vështirë të vlerësohet ndikimi i Këshillit në përmirësimin e punës dhe punësimit. Në fakt, ndoshta i vetmi informim që mund të marrim në këtë aspekt është nga grupet punuese mbi ndryshimin e Ligjit të Punës, në të cilin ka qenë anëtar edhe KES. Andaj, kjo na kthen

¹⁹ Krasniqi, Nida. Analizë e Shkurtër mbi Dialogun Social në Kosovë. *Peer Educators Network*. Tetor 2017. Marrë nga: http://www.ngo-pen.org/wp-content/uploads/2017/07/Updated_Dialogu-social-ne-Kosove_RGB-copy.pdf

sërish tek pika se KES duhet të punojë në ruajtjen dhe publikimin e punës së tij, në mënyrë që matja e performancës të bëhet në mënyrë më të lehtë dhe drejtpërdrejtë.

Pika 3: Propozimet për pagën minimale

Sipas Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, por edhe në bazë të Ligjit të Punës, KES-i është organi përgjegjës i cili i propozon Qeverisë lartësinë e pagës minimale në fund të çdo viti kalendarik. Mirëpo, paga minimale në Kosovë për herë të fundit është caktuar në vitin 2011 me vendimin e Qeverisë së Kosovës, edhe pse nuk ka informata se si ka ardhur deri te ai vendim, a ka qenë propozim i Këshillit, a janë organizuar diskutime, si dhe çfarë faktorë janë marrë parasysh për caktimin e kësaj page. Me këtë vendim është përcaktuar se paga minimale do të jete 130 Euro për personat nën moshën 35 vjeçare dhe 170 Euro për personat nga 35-65 vjeç.

Sigurisht, mos ndryshimi i pagës minimale e bën përgjegjës në radhë të parë vet Këshillin Ekonomiko-Social si organin përgjegjës për propozim të pagës minimale. Në një rën nga mbledhjet e Këshillit Ekonomiko-Social është raportuar se është diskutuar për pagën minimale, dhe palët janë marrë vesh që paga minimale për vitin 2013 të jetë 220 Euro, mirëpo nuk ka informacione se a i është dërguar Qeverisë së Kosovës ky propozim²⁰.

Vetëm në vitin 2016 është raportuar se Këshilli Ekonomiko-Social i ka propozuar Qeverisë së Kosovës rritjen e pagës minimale në 210 Euro dhe heqjen e kategorizimit të moshës, si një kriter diskriminues²¹. Përsëri nuk dihen arsyet se pse Qeveria e Kosovës nuk e ka pranuar këtë propozim të KES-it, duke parë që edhe në vitin 2017 kemi pagën e njëjtte minimale të caktuar në vitin 2011.

Si arsye e mospranimit të rritjes së pagës minimale nga Qeveria sipas propozimit të KES-it, është fakti se Këshilli ka vetëm funksion këshillëdhënës dhe rekomandues. Gjithsesi, prapë mbetet në përgjegjësinë e Këshillit që të insistojë që propozimet e tij të merren parasysh, nëse ato janë të bazuara.


Në aspekt të propozimeve mbi pagën minimale, për qëllime të këtij punimi kemi vendosur që të analizojmë raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës mbi Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, për të parë se a ka pasur ndryshime në çmimet e konsumit, dhe rrjedhimisht të vlerësohet nga ky aspekt nevoja për ndryshim apo jo të pagës minimale²².

Të dhënat do të paraqesim që nga viti 2011, vitin kur për herë të fundit është përcaktuar paga minimale në Kosovë. Në vitin 2011 indeksi i tërësishëm i çmimeve të konsumit ishte 7.4% më i lartë se në vitin 2010. Kjo do të thotë se shkalla e inflacionit në vitin 2011 ishte 7.4%.

²⁰ Këshilli Ekonomiko Social. Dhjetor, 2012. Marrë nga: <http://www.bspk.org/pdf/kes2012.pdf>

²¹ Telegrafi. "Paga minimale, 210 euro". Mars, 2016. Marrë nga: <http://telegrafi.com/paga-minimale-210-euro/>

²² Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është tregues relativ që paraqet dinamikën e ndryshimeve apo lëvizjen e çmimeve me pakicë për artikujt e shërbimet më reprezentues të konsumuar nga ekonomitë familjare në periudhë të caktuar kohore të përfshirë në grupe dhe nëngrupe të klasifikuara sipas nomenklaturës ndërkombëtare të ashtuquajtur COICOP (Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit).



Shkalla e inflacionit në Kosovë kishte ngritje edhe në vitet pasuese: në vitin 2012 ishte 2,5%, 2013 1,8%, 2014 0.4%, 2015 (-0.5%), 2016 0.3%²³. Në muajin korrik 2017 shkalla e inflacionit ishte 1.7%, krahasuar me muajin korrik të vitit 2016. Nga këto të dhëna shihet se shkalla e inflacionit nga viti 2012 ka pasur ngritje të ndjeshme, përjashtuar vitin 2015 ku shkalla e inflacionit ka rënë për 0.5%²⁴. Andaj, nëse paga minimale analizohet vetëm në aspektin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit, një rritje e këtij të fundit do të duhej të përcillej me rritjen e pagës minimale. mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur që nga viti 2011.

Pika 4: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive

Si një ndër të arriturat kryesore të Këshillit Ekonomiko-Social, padyshim është nënshkrimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive nga tre anëtarët e Këshillit Ekonomiko-Social në vitin 2014. Nënshkrues të kësaj marrëveshje ishin: Përfaqësues nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Përfaqësues nga Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale). Nënshkrimi i kësaj marrëveshje, përveç rëndësisë së madhe që ka për përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësi të punëtorëve dhe punëdhënësve, konsiderohet një e arritur e madhe për faktin që për nënshkrimin e kësaj marrëveshje është arritur konsensus mes palëve të cilat parimisht kanë interesa të ndryshme. Përfaqësuesit e punëdhënësve angazhohen për të drejtat e bizneseve, e që shpesh herë janë interesa të kundërta me interesat e punëtorëve. Prandaj të arrihet një konsensus i tillë sigurisht që nuk ka qenë e lehtë.

Mirëpo, edhe pse ka 3 vite që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive është nënshkruar ende nuk është duke u zbatuar. Për mos zbatimin e kësaj Marrëveshje, ka bërë thirrje disa herë Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Sipas kësaj ode, kjo Marrëveshje nuk duhet të zbatohet për arsye se disa nga dispozitat e kësaj marrëveshje janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës. OEAK i referohet nenit 71 të Marrëveshjes ku thuhet se palët nënshkruese janë të obliguara ti zbatojnë dispozitat e marrëveshjes, ndërsa neni 90 i Ligjit të Punës parasheh që dispozitat e Kontratës Kolektive vlejnë vetëm për ata punëdhënës dhe punëmarrës që marrin përsipër dispozitat e përcaktuara me Marrëveshjen

²³ Seritë e mëhershme të IHÇK janë publikuar duke marrë për bazë muajin maj 2002=100, ndërsa nga janari i vitit 2015 si bazë e shkallës së inflacionit merret viti 2015=100.

²⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa e ekonomike shtëpiake bujqësore 2004. Qershor, 2017. Marrë nga: <http://ask.rks-gov.net/media/3311/i%C3%A7k-ih%C3%A7k-2002-2016-shqip.pdf>

Kolektive. Pra sipas ligjit punëdhënësve dhe punëmarrësve u lihet në diskrecion të vendosin se a dëshirojnë të zbatojnë dispozitat e Marrëveshjes²⁵.

Edhe Oda Ekonomike e Kosovës, që ka qenë palë nënshkruese e Marrëveshjes, si përfaqësuese e punëdhënësve, ka kërkuar që të pezullohet marrëveshja, me arsyetimin se anëtarët e tyre nuk janë konsultuar para nënshkrimit të marrëveshjes²⁶.

Duke parë situatën e krijuar, dhe moszbatimin e Marrëveshjes nga palët nënshkruese, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, e pezulloi Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive. Sipas tij pezullimi është bërë për shkak të disa neneve që kanë qenë në kundërshtim me Ligjin e Punës si dhe për arsye se pezullimi është kërkuar nga njëra palë nënshkruese, në këtë rast nga Oda Ekonomike e Kosovës.

Edhe pse Marrëveshja ka qenë në fuqi për më shumë se një vit, përsëri nuk është vërejtur ndonjë rast kur ajo është zbatuar. E kjo shton dyshimet se kjo Marrëveshje është nënshkruar pa u diskutuar dhe konsultuar mjaftueshëm nga partnerët e Këshillit Ekonomiko-Social. Tani duhet të presim dhe të shohim se çka do të ndodh me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, a do të kthehet në zbatim, apo do të pritet ndryshimi i Ligjit të Punës dhe Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social. Meqenëse këto ligje nuk janë dërguar në Qeveri dhe/ose nuk janë proceduar në Kuvend për miratim, të njëjtat duhet të kthehen në pikën zero të amandamentimit, pra të përgatiten draftet e reja, të mbahen konsultimet publike, etj., dhe pastaj të dërgohen në Qeveri e cila duhet t'i procedojë në Kuvend. Duke marrë parasysh se janë dy ligje mjaft sensitive, është e pritshme që iniciimi i amandamentimit të tyre të vonohet deri në një masë.

Rekomandime

Pas analizimit të punës së Këshillit Ekonomiko-Social, evidentimit të mangësive dhe krahasimit me vendet e rajonit, ky raport jep këto rekomandime:

- 1) Të ndryshohen kriteret për përfaqësim të organizatave në Këshill, pasi që kriteret aktuale mund ti përmbushin vetëm një numër minimal i organizatave. Me ndryshimin e kriterëve do të rritej konkurrenca e organizatave për të qenë anëtare të KES-it
- 2) Të rritet numri i anëtarëve të Këshillit, në mënyrë që punëtorët dhe punëdhënësit të përfaqësohen me më shumë organizata në Këshill. Kjo do ishte pozitive sepse do të kishte përfaqësim më të madh sektorial në Këshill
- 3) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të raportojë me shkrim për menaxhimin e buxhetit të Këshillit
- 4) Mënyra e vendimmarrjes të jetë me konsensus. Kjo për arsye se votimi me 2/3 mund të arrihet edhe pa pëlqimin e njërit nga partnerët social. Alternativë tjetër e pranushme është që të mbetet mënyra e vendimmarrjes me 2/3, me kusht që në këto 2/3 të votave, të jetë së paku nga një votë nga të gjithë partnerët social.
- 5) Të caktohet kalendari i takimeve të Këshillit, për të mos pasur mungesa në takime si pasojë e mos informimit
- 6) Të bëhet informimi i publikut për punën e Këshillit, pasi që momentalisht ka shumë pak informacione për punën e KES-it.

²⁵ Insajderi. "Oda amerikane marrëveshje kolektive nuk mbështetet në ligjet aktuale të punës". Prill, 2016. Marrë nga: <http://www.insajderi.com/oda-amerikane-marreveshje-kolektive-nuk-mbeshtetet-ne-ligjet-aktuale-te-punes/>

²⁶ Partneret Social. "Një mendim ligjor i pavarur për Marrëveshjen kolektive". Prill, 2016. Marrë nga: <http://www.partneretsocial.org/Al/artikuj/246/nje-mendim-ligjor-i-pavarur-per-marreveshjen-kolektive/>